



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 28 janar 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të Akuzuarit

Zhan Lui Zhilisen

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, pas një vendimi të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ("Vendimi i Konfirmimit"),² Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, pas një vendimi dhe fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala ("z. Shala" ose "i akuzuari") u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës ("Belgjika").⁵

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Një version i redaktuar konfidencial dhe një version i redaktuar publik u nxorën më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 Mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik. Versioni konfidencial me edhe më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01. Pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për mocionin e Mbrojtjes që kundërshton formën e Aktakuzës së Konfirmuar, u dorëzua një aktakuzë e korrigjuar më 1 nëntor 2021, F00098/A01, konfidenciale, dhe 16 nëntor 2021, F00107/A01, publike.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial (një version i redaktuar publik u lëshua më 6 maj 2021, F00008/RED); F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar publik u lëshua më 15 prill 2021, F00008/A01/RED).

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.⁶
4. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi kërkesën për lirim të përkohshëm të parashtruar nga Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja") ("Vendimi i Parë për Paraburgimin").⁷ Më 20 gusht 2021, Gjykata e Apelit konfirmoi Vendimin e Parë për Paraburgimin ("Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit").⁸
5. Më 10 shtator 2021 dhe 10 nëntor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rishikoi paraburgimin e z. Shala dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij (përkatësisht, "Vendimi i Dytë për Paraburgimin" dhe "Vendimi i Tretë për Paraburgimin").⁹
6. Më 18 nëntor 2021, pas një kërkesë të z. Shala, i cili hoqi dorë nga e drejta për rishikimin e masës së paraburgimit para përfundimit të afatit dymujor, përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores,¹⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshoi afatin e Mbrojtjes për dorëzimin e parashtrimeve mbi rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala për më 17 dhjetor 2021, ose për dorëzimin e

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. Një version i redaktuar publik u nxor më 26 prill 2021, F00019/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00045, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm*, 15 qershor 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u nxor më 23 qershor 2021, F00045/RED.

⁸ KSC-BC-2020-04, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm*, 20 gusht 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u nxor të njëjtën ditë, IA001/F00005/RED.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00075, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 shtator 2021, konfidencial (një version i redaktuar publik u nxor të njëjtën ditë, F00075/RED); F00105, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 nëntor 2021, konfidencial (një version i redaktuar publik u nxor të njëjtën ditë, F00105/RED).

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00108, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Parashtrimet e saj lidhur me Rishikimin e Paraburgimit të z. Shala*, 16 nëntor 2021, publike, para. 3.

përgjigjes ndaj parashtrimeve të mundshme të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”), nëse dëshiron, për më 21 janar 2022 (“Vendimi i 18 nëntorit 2021”).¹¹

7. Më 16 dhjetor 2021, pas një urdhri të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,¹² Mbrojtja bëri të ditur se nuk do të kërkojë ndryshim të mëtejshëm të afatit pas apelit të saj kundër Vendimit të Tretë për Paraburgimin,¹³ se do t’i paraqesë parashtrimet e veta sipas kalendarit të përcaktuar në vendimin e 18 nëntorit 2021, dhe se do t’i përgjigjet çdo parashtrimi të mundshëm të ZPS-së deri më 21 janar 2022.¹⁴

8. Më 11 Janar 2022, ZPS-ja paraqiti parashtrimet e veta për rishikimin e paraburgimit të z. Shala (“Parashtrimet e ZPS-së”).¹⁵

9. Më 21 janar 2022, Mbrojtja paraqiti parashtrimet e veta (“Parashtrimet e Mbrojtjes”).¹⁶

II. PARASHTRIMET

10. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të z. Shala vijon të jetë i domosdoshëm dhe proporcional dhe kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të urdhërojë mbajtjen e tij të mëtejshme në paraburgim.¹⁷ Për mendimin e ZPS-së, nuk

¹¹ KSC-BC-2020-04, F00110, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Parashtrimet e saj lidhur me Rishikimin e Ardhshëm të Paraburgimit të z. Shala*, 18 nëntor 2021, publik, para. 9.

¹² KSC-BC-2020-04, F00121, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Parashtrime*, 14 dhjetor 2021, publik.

¹³ KSC-BC-2020-04, IA003/F00001, Mbrojtësi i Specializuar, *Apel i Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës të 10 nëntorit 2021*, 22 Nëntor 2021, konfidencial (“Apeli i Mbrojtjes kundër Vendimit të Tretë për Paraburgimin”).

¹⁴ KSC-BC-2020-04, F00125, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime sipas Urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të datës 14 dhjetor 2021*, 16 dhjetor 2021, publike, para. 2.

¹⁵ KSC-BC-2020-04, F00128, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë lidhur me Rishikimin e Tretë të Paraburgimit*, 11 Janar 2022, publike.

¹⁶ KSC-BC-2020-04, F00131, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë lidhur me Rishikimin e Tretë të Paraburgimit*, 21 Janar 2022, publike.

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 8.

ka ndodhur asnjë ndryshim i rëndësishëm i rrethanave që kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori këtë përfundim në Vendimin e Tretë për Paraburgimin.¹⁸

11. Mbrojtja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të urdhërojë menjëherë lirimin e përkohshëm të z. Shala, me ose pa kushte.¹⁹

III. LIGJI I ZBATUESHËM

12. Neni 41(6) i Ligjit parashikon se DHS-ja urdhëron paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer një vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së, dhe kur ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) përbën rrezik arratisjeje; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose rrethana specifike tregojnë se personi do të pengojë ecurinë e procedurës penale, ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale në tentativë, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

13. Neni 41(10) i Ligjit parashikon që deri në kohën kur aktgjykimi të merr formën e prerë, ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas aktvendimit të fundit për paraburgim, gjykatësi i procedurës paraprake ose trupi gjykues i informuar për rastin shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerr aktvendim për lirimin apo ndërprerjen e paraburgimit. Kjo del edhe nga rregulla 57(2) e Rregullores.

14. Neni 41(12) i Ligjit parashikon që krahas paraburgimit mund të urdhërohen edhe masat e mëposhtme, për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, paraburgimi shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve ose personave të caktuar,

¹⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1-2.

¹⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 8, 32.

paraqitja në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

15. Në pajtim me rregullën 56(2) të Rregullores, paneli siguron që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes. Në rast vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pasi të ketë dëgjuar palët, paneli mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

16. ZPS-ja parashtron se vendimi sipas rregullës 57(2) të Rregullores lidhet në mënyrë të pashmangshme me ndryshimin e rrethanave, nëse ka ndonjë ndryshim të tyre që nga vendimi i fundit për paraburgimin.²⁰ ZPS-ja argumenton gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorët për të cilët tashmë është marrë vendim në vendimin fillestar mbi paraburgimin.²¹

17. Mbrojtja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet ta shqyrtojë paraburgimin në mënyrë efikase dhe jo thjesht të miratojë kërkesën e ZPS-së për vazhdimin e paraburgimit në mungesë të arsytimit konkret dhe faktimit të rreziqeve përkatëse.²² Mbrojtja parashtron se, sipas kornizës ligjore të DHS-së, për të kryer një vlerësim të plotë nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim, nuk kërkohet të ketë pasur ndryshim të rrethanave, dhe se mbështetja e ZPS-së në rregullën 57(2) të Rregullores në këtë kontekst është e pavend.²³ Së fundi, Mbrojtja parashtron se supozimi që çdo i akuzuar në pritje të gjykimit mund të mbahet në paraburgim për sa

²⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

²¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

²² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 4-6.

²³ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10.

kohë që mund të zgjasë gjykimi për shkak të “mosndryshimit” të rrethanave, është qartësisht i gabuar dhe thellësisht i padrejtë.²⁴

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, sipas nenit 41(10) të Ligjit, ai ka detyrimin të shqyrtojë nëse arsyet për paraburgim vazhdojnë të ekzistojnë, përfshirë arsyet e parashikuara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht nëse: (i) ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer veprën ose veprat penale; dhe (ii) ka arsye të artikulueshme për të besuar se ndonjëri prej rreziqeve të parashikuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit është materializuar.²⁵ Detyrimi për të përcaktuar nëse ekzistojnë ende rrethanat mbi të cilat mbështetet paraburgimi i imponon panelit kompetent detyrën që të vlerësojë, *proprio motu*, nëse në kohën e rishikimit dhe në rrethanat konkrete të çështjes kur bëhet rishikimi, është ende i bindur se paraburgimi i të akuzuarit vazhdon të jetë i përligjur.²⁶ Megjithëse rishikimi automatik çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk kufizohet rreptësisht me ndryshimin apo jo të rrethanave, një ndryshim i tillë megjithatë mund të jetë përcaktues dhe duhet të merret parasysh nëse ngrihet nga ndonjëra nga palët apo *proprio motu*.²⁷ Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i kërkohet të bëjnë konstatime për faktorët për të cilët tashmë është marrë vendim në vendimin fillestar për paraburgimin, e as të shqyrtojë parashtrime të cilat thjesht përsërisin argumente që ndërkohë janë trajtuar në vendime të mëparshme.²⁸ Me rëndësi thelbësore është që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bindet se, në kohën e vendimit të rishikimit, arsyet për vazhdimin e paraburgimit ende ekzistojnë.²⁹ ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.³⁰ Kjo do

²⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes , para. 5.

²⁵ KSC-BC-2020-07, IA002-F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim i Apelit të Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit (“Apeli i Paraburgimit të Haradinajt”)*, 9 shkurt 2021, publik, para. 55.

²⁶ KSC-BC-2020-06, IA006-F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim i Apelit të Jakup Krasniqit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit (“Apeli i Paraburgimit të Krasniqit”)*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 15. Një version i redaktuar publik doli të njëjtën ditë, IA006/F00005/RED.

²⁷ Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 16.

²⁸ Apeli i Paraburgimit të *Haradinajt*, para. 55; Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 17.

²⁹ Apeli i Paraburgimit të *Haradinajt*, para. 55.

³⁰ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 13, me referenca të mëtejshme.

të thotë se ZPS-ja duhet të paraqesë argumente specifike dhe prova konkrete për të vërtetuar se në kohën e rishikimit, vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm.

B. DYSHIM I BAZUAR

19. Për sa i takon standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit së pari kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer veprë penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.³¹

20. Sipas ZPS-së, për arsyet e shtjelluara në Vendimin e Konfirmimit dhe në Vendimin e Tretë për Paraburgimin, vazhdon të ekzistojë dyshim i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer një numër veprash penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së.³² Mbrojtja nuk ka bërë asnjë parashtrim në lidhje me këtë kriter.

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Konfirmimit, u konstatua se sipas nenit 39(2) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Shala është penalisht përgjegjës për një numër krimesh lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit.³³ Këto konstatime u bënë në bazë të një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.³⁴

22. Në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi të ri në lidhje me vendimin aktual, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kriteri i parashikuar në nenin 41(6)(a) të Ligjit vazhdon të përmbushet.

³¹ *Po ashtu*, ECtHR/GJEDNJ, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222, me referenca të mëtejshme.

³² Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 4.

³³ Vendimi i Konfirmimit, para. 140(a); *shih gjithashtu*, Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 15; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 22; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 19.

³⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 35; *shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-06, IA008-F00004, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21. Një version i redaktuar publik doli të njëjtën ditë, IA008/F00004/RED.

C. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

23. Me përmbushjen e kriterit të nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që do të përlligjnin heqjen e lirisë së një personi duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që duhet të specifikohen me hollësi.³⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton më tej se, në bazë të provave të disponueshme, këto arsye të artikulueshme dhe specifike duhet të mbështesin “besimin”³⁶ se ekziston ndonjëri prej rreziqeve të parapara në tre nënparagrafët e nenit 41(6)(b) të Ligjit, që nënkupton pranimin e mundësisë, dhe jo të pashmangshmërisë, që ato të ndodhin në të ardhmen.³⁷ Me fjalë të tjera, sipas këtij standardi, duhet të tregohet se është më pak se e sigurt, por më shumë se thjesht e mundur, që ndonjë prej këtyre rreziqeve të materializohet.³⁸ Për të vendosur nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve të parashikuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.³⁹

24. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren që Mbrojtja parashtron se u përmbahet plotësisht parashtrimeve të veta të mëparshme për paraburgimin e z. Shala dhe thekson se nuk ka asnjë bazë të përshtatshme mbi të cilën z. Shala duhet të mbahet i paraburgosur.⁴⁰ Sikundër është përcaktuar më lart dhe në Vendimin e Tretë për Paraburgimin, Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i kërkohet të bëjë konstatime për faktorët për të cilët tashmë është marrë vendim në vendimin fillestar për paraburgimin, e as të shqyrtojë parashtrime që thjesht përsërisin argumente që janë trajtuar në vendime të mëparshme.⁴¹ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake

³⁵ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca të mëtejshme.

³⁶ *Shih pjesën e përgjithshme të nenit 41(6)(b) të Ligjit.*

³⁷ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca të mëtejshme.

³⁸ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca të mëtejshme.

³⁹ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, 26 prill 2017, publik, para. 114; shih gjithashtu, ECtHR/GJEDNJ, Buzadji v. the Republik of Moldova [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“Buzadji v. the Republik of Moldova [GC]”), para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012, para. 140 *in fine*.*

⁴⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 17, 22.

⁴¹ Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 24, 28, 32.

nuk do t'i shqyrtojë këto parashtrime më tej dhe si pasojë, në pjesët e mëposhtme do të trajtohen vetëm argumentet që nuk janë ngritur dhe shqyrtuar më parë.

1. Rreziku i arratisjes

25. Sipas ZPS-së, rreziku i arratisjes në lidhje me z. Shala vazhdon të ekzistojë.⁴² ZPS-ja shton se ky rrezik ka mbetur i pandryshuar apo është shtuar që nga Vendimi i Tretë për Paraburgimin me ecurinë e procedurave drejt fillimit të gjykimit.⁴³

26. Mbrojtja përgjigjet se ZPS-ja argumenton në mënyrë të pamjaftueshme dhe të përgjithshme se rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit vazhdojnë të ekzistojnë, kanë mbetur të njëjtë apo potencialisht janë shtuar që nga Vendimi i Tretë për Paraburgimin, dhe se ZPS-ja vazhdon të mos jetë në gjendje të vërtetojë ekzistencën e ndonjërit prej rreziqeve të pretenduara, për shembull, duke bërë të njohur apo duke e lidhur ndonjë prej materialeve të nxjerra për veprimtarinë e pretenduar kriminale të z. Shala me faktimin e përligjur të rrezikut të shtuar.⁴⁴ Mbrojtja argumenton gjithashtu se njohja gjithnjë e më e plotë me provat në vetvete nuk i shton rreziqet e identifikuar, ndërkohë që e kundërta mund të ishte e vërtetë, po të merret parasysh nxjerrja e materialeve qartësisht shfajësuese.⁴⁵

27. Pasi shqyrtimit të faktorëve dhe rrethanave të përmendura në Vendimin e Parë, të Dytë dhe të Tretë për Paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdon të jetë i bindur se ato vazhdojnë të ekzistojnë. Më konkretisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se z. Shala: (i) është në dijeni të akuzave të rënda kundër tij, të mundësisë së marrjes së një dënimi të rëndë për ato akuza në rast se shpallet fajtor dhe të vendimit të formës së prerë për fajësinë e dy anëtarëve të Ndërmarrjes

⁴² Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 5.

⁴³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 5.

⁴⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 20-21.

⁴⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 24.

Kriminale të Përbashkët ("NKP") anëtar i së cilës pretendohet se ka qenë edhe ai vetë; dhe se (ii) refuzon legjitimitetin e DHS-së.⁴⁶ Gjithashtu: (i) madhësia relativisht e vogël e grupit që përbën NKP-në e pretenduar dhe fakti që ngjarjet mbi të cilat mbështeten akuzat janë lehtësisht të dallueshme, e shtojnë mundësinë e ndihmës së ndërsjellë midis anëtarëve të pretenduar të saj, përfshirë edhe duke ndihmuar njëri-tjetrin për t'u arratisur; dhe (ii) ekziston një kontekst i përgjithshëm i një atmosfere të përgjithshme, të rrënjosur dhe të vazhdueshme të ndërhyrjes në proceset penale që kanë lidhje me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe të frikësimit të dëshmitarëve.⁴⁷ Këta faktorë dhe rrethana vijojnë të vërtetojnë se aktualisht ekziston një rrezik i moderuar që z. Shala të arratiset. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se rreziku i arratisjes nuk është rritur si rrjedhojë e ecures së procedurave, duke marrë parasysh se faktorët dhe rrethanat e lartpërmendura nuk varen nga zhvillime të tilla. Duke argumentuar në mënyrë të përgjithshme se ZPS-ja nuk arrin ta provojë këtë rrezik, Mbrojtja nuk merr parasysh se faktorët dhe rrethanat e lartpërmendura janë faktuar në vendimet e mëparshme dhe se, për nevojat e këtij vendimi, është përcaktuese që ato vazhdojnë të ekzistojnë dhe vërtetojnë ekzistencën e një rreziku të moderuar arratisjeje.

2. Rreziku i pengimit të ecures së procedurave të DHS-së

28. Sipas ZPS-së, rreziku se z. Shala do të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së vazhdon të ekzistojë.⁴⁸ ZPS-ja shton se ky rrezik mund të jetë rritur me ecurinë e mëtejshme të procedurave që nga Vendimi i Tretë për Paraburgimin.⁴⁹

⁴⁶ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 24-25; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 28; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 25.

⁴⁷ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 26; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 28; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 25.

⁴⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 5.

⁴⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 5.

29. Krahas parashtrimeve të paraqitura më lart lidhur me rrezikun e arratisjes,⁵⁰ Mbrojtja parashtron se zhvillimet në lidhje me një dëshmitar kyç, [REDAKTUAR], në mënyrë të pashmangshme zvogëlojnë çdo rrezik të perceptuar.⁵¹

30. Rikujtohet se [REDAKTUAR].⁵² [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].⁵³ [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

31. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se ekzistenca e masave mbrojtëse në këtë çështje gjyqësore nuk bie ndesh me konstatimin se ka një rrezik pengimi në rrethanat e çështjes në fjalë dhe se, më në përgjithësi, domosdoshmëria e masave të tilla demonstroi një rrezik të shtuar, duke qenë se ngjarjet mbi të cilat mbështeten akuzat janë lehtësisht të dallueshme.⁵⁴

32. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton më tej se, [REDAKTUAR], ecuria e mëtejshme e fazës paraprake të procedurave pas Vendimit të Tretë për Paraburgimin, veçanërisht dorëzimi i pritshëm i Dosjes Paraprake të ZPS-së deri më 28 janar 2022, e shton rrezikun e pengimit, sepse ajo do t'i ofrojë z. Shala informacion më të hollësishëm lidhur me provat kundër tij dhe përfundimisht do të çojë në heqjen e disa masave mbrojtëse. Pretendimi i Mbrojtjes se disa prej materialeve të nxjerra nga ZPS-ja janë shfajësuese, nuk e cenon këtë konstatim. Mbrojtja shpërfill faktin se njohja gjithnjë e më e plotë e z. Shala me provat kundër tij duhet të vlerësohet kundrejt [REDAKTUAR].

33. Gjithashtu, parashtrimi i përgjithshëm i Mbrojtjes se rreziku i pengimit nuk është i faktuar nuk vlen, duke qenë se nuk merr parasysh që faktorët dhe rrethanat mbi të cilat mbështetet ky rrezik janë përcaktuar në vendime të mëparshme për

⁵⁰ *Shih* para. 26 më lart; Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 20-21, 24.

⁵¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19 që i referohen Apelit të Mbrojtjes kundër Vendimit të Tretë për Paraburgimin, para. 24.

⁵² Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 32-35; Vendim i Gjykatës së Apelit, para. 35-42; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 29.

⁵³ *Shih gjithashtu*, Vendim i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 36.

⁵⁴ Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 31; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 29.

paraburgimin dhe janë konfirmuar në apel.⁵⁵ Në lidhje me këtë, për nevojat e këtij vendimi, është përcaktuese se rreziku i pengimit të procedurave të DHS-së nga z. Shala vazhdon të ekzistojë për faktin se [REDAKTUAR].

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

34. Sipas ZPS-së, rreziku se z. Shala do të kryejë krime të tjera vazhdon të ekzistojë.⁵⁶ ZPS-ja shton se ky rrezik mund të jetë shtuar me ecurinë e fazës paraprake të procedurave që nga Vendimi i Tretë për Paraburgimin.⁵⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes janë përshkruar më lart në lidhje me rrezikun e arratisjes dhe të pengimit.⁵⁸

35. Në Vendimin e Parë, të Dytë dhe të Tretë për Paraburgimin, u konstatua se ekziston rreziku që z. Shala të kryejë krime të tjera, duke qenë se [REDAKTUAR].⁵⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktin që ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, por thekson se në këtë çështje gjyqësore, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë me rëndësi edhe për vlerësimin e rrezikut të fundit.⁶⁰ Për mendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, rreziku që z. Shala të kryejë krime të tjera vazhdon të ekzistojë, duke marrë parasysh se [REDAKTUAR]. Gjithashtu, ashtu si në rastin e rrezikut të pengimit të procesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se ecuria e fazës paraprake të procedurave që nga Vendimi i Tretë për Paraburgimin, veçanërisht dorëzimi i pritshëm i Dosjes Paraprake të ZPS-së, shton rrezikun që z. Shala të kryejë krime të tjera. Së fundi, argumenti i Mbrojtjes se rreziku që z. Shala

⁵⁵ *Shih në veçanti*, Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 32-35; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 34-42.

⁵⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 5.

⁵⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 5.

⁵⁸ *Shih* para. 26 dhe 29 më lart; Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19-21, 24.

⁵⁹ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 39; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 36; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 33.

⁶⁰ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 39; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 36; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 33.

të kryejë krime të tjera nuk është vërtetuar, nuk duhet të merret parasysh për të njëjtat arsye të identifikuar lidhur me rrezikun e pengimit.⁶¹

4. Përfundim

36. Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Shala të arratiset, të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së, ose të kryejë vepra penale të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që i kanë dhënë dëshmi ZPS-së dhe/ose pritët të paraqiten para DHS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të trajtohen si duhet me anë të vendosjes së kushteve për lirimin e përkohshëm të z. Shala.

D. LIRIMI ME KUSHT

37. ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar më herët se kushtet e propozuara nuk i zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.⁶² ZPS-ja shton se këto rreziqe mund të zvogëlohen në mënyrë efektive vetëm me anë të vazhdimin të paraburgimit të të akuzuarit, dhe se çdo garanci që i akuzuari mund të japë do të ishte e pamjaftueshme për të tejkaluar rreziqet konkrete që do të shkaktonte lirimin e tij.⁶³

38. Mbrojtja parashtron se ZPS-ja shpërfill konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin e Parë për Paraburgimin sipas të cilit, rreziku i moderuar i arratisjes mund të zvogëlohet me vendosjen e kushteve të duhura.⁶⁴ Gjithashtu, Mbrojtja fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të vlerësojë kushtet e paraqitura nga Mbrojtja lidhur me Vendimin e Tretë për Paraburgimin, në veçanti, kushtin e propozuar të monitorimit efektiv të komunikimeve të z. Shala, përfshirë

⁶¹ *Shih*, para. 30-33 më lart.

⁶² Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

⁶³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

⁶⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 21.

komunikimet në gjuhën shqipe (“Kushtet e Propozuara”).⁶⁵ Mbrojtja gjithashtu propozon që z. Shala të vihet në arrest shtëpiak në vendbanimin e tij në Belgjikë, bashkë me kushte të tjera shtesë.⁶⁶ Së fundi, Mbrojtja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit, të urdhërojë paraqitjen e dëshmimeve të ekspertëve lidhur me monitorimin e komunikimeve në përgjithësi dhe mjetet e disponueshme në Belgjikë për një monitorim të tillë nga distanca, duke përfshirë, në rast se gjykohet e nevojshme, parashtrime lidhur me kapacitetet për monitorimin e komunikimeve në gjuhën shqipe.⁶⁷ Mbrojtja argumenton se për kërkimin e këshillave të ekspertëve nevojitet një urdhër i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, duke qenë se ajo vetë nuk ka mundësi të mbulojë shpenzimet në mënyrë të pavarur, për shkak të fondeve të kufizuara që ka.⁶⁸

39. Për sa i takon rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake më parë ka konstatuar se kushtet e propozuara në lidhje me Vendimin e Parë për Paraburgimin, përkatësisht, zotimet e z. Shala për t’iu nënshtruar kontrolleve të përditshme të zyrtarëve të autorizuar belgë, për të dorëzuar të gjitha dokumentet e udhëtimit dhe për t’iu nënshtruar monitorimit të rreptë të autoriteteve belge, e zvogëlojnë mjaftueshëm këtë rrezik.⁶⁹ Duke marrë parasysh se parashtrimet e përgjithshme të ZPS-së në lidhje me këtë çështje nuk mbështeten në prova, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në mungesë të një informacioni apo zhvillimi të ri në lidhje me këtë vendim, kushtet e lartpërmendura mbeten të përshtatshme për të zvogëluar rrezikun e arratisjes së z. Shala.

⁶⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 7, 9, 28, 31, 32.

⁶⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 6, 9, 28, 31, 32.

⁶⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 9, 29.

⁶⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 29.

⁶⁹ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 45; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 40; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 37.

40. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Kushtet e Propozuara dhe mundësia e arrestit shtëpiak me kushte shoqëruese janë ngritur më herët⁷⁰ dhe janë shqyrtuar në Vendimin e Parë, të Dytë dhe të Tretë për Paraburgimin.⁷¹ Ndërsa këto parashtrime të përsëritura nuk ka nevojë të shqyrtohen më tej,⁷² Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton gjithsesi se: (i) Kushtet e Propozuara nuk trajtojnë mundësinë që z. Shala të përdorë pajisje komunikimi që u përkasin të tjerëve apo t'u kërkojë të tjerëve të përdorin pajisjet e tyre për këtë qëllim, dhe kushtet e zbatimit janë të pamjaftueshme për të siguruar monitorim efektiv të komunikimeve të z. Shala, duke pasur parasysh rreziqet e identifikuara sipas nenit 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit; dhe (ii) mundësia e arrestit shtëpiak dhe kushteve shoqëruese nuk do të parandalonin bisedat e pamonitoruara midis z. Shala dhe vizitorëve të miratuar.⁷³ Vlen të rikujtohet gjithashtu se është përcaktuar se kushtet shoqëruese, si vizitat e monitoruara nga autoritetet belge, nuk do ta zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun për shkak të mundësisë së përdorimit të gjuhës së koduar apo të pakuptueshme, të cilën personat që nuk kanë njohuri për procedurat e DHS-së nuk mund ta njohin ose ta parandalojnë lehtë, ndërkohë që komunikime të tilla, përfshirë komunikimet në gjuhën amtare të z. Shala, gjithsesi do t'i nënshtroheshin njëfarë monitorimi në mjediset e kontrolluara të objektit të paraburgimit të DHS-së.⁷⁴ Në mungesë të garancive të Belgjikës dhe pasi ka konstatuar se Kushtet e Propozuara, arresti shtëpiak dhe kushtet shtesë janë të

⁷⁰ *Shih për shembull*, KSC-BC-2020-04, F00099, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Dytë të Paraburgimit*, 1 nëntor 2021, publike ("Parashtrimet e Mbrojtjes të 1 nëntorit 2021"), para. 37.

⁷¹ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 46-48; Vendim i Gjykatës së Apelit, para. 53-58, 61; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 41-42; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 38.

⁷² Apeli i Paraburgimit të *Haradinajt*, para. 55; Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 17.

⁷³ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 46-48; Vendim i Gjykatës së Apelit, para. 53-58; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 41-42; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 38.

⁷⁴ Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 42; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 38; KSC-BC-2020-06, IA010-F00008, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit ("Apeli i Paraburgimit të Thaçit")*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 68. Një version i redaktuar publik doli të njëjtën ditë, IA010-F00008/RED.

pamjaftueshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nuk ka bazë për të kërkuar informacion të mëtejshëm nga Belgjika.⁷⁵

41. Gjithashtu, ndonëse kërkesa e Mbrojtjes për të urdhëruar paraqitjen e dëshmimeve të ekspertëve nuk ka nevojë të vlerësohet duke qenë se është ngritur⁷⁶ dhe trajtuar⁷⁷ më parë,⁷⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se pamjaftueshmëria e Kushteve të Propozuara, arrestit shtëpiak dhe kushteve shtesë nuk varet vetëm nga komunikimet e z. Shala me anë të pajisjeve të ndryshme dhe, rrjedhimisht, dëshmi të tilla ekspertësh nuk janë të nevojshme për qëllimet aktuale.⁷⁹

42. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdon të jetë i bindur se komunikimet e z. Shala mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e lartpërmendura vetëm me anë të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kushtet e propozuara, arresti shtëpiak dhe çdo kusht tjetër shtesë i vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake janë të pamjaftueshme për zvogëlimin e rrezikut që z. Shala të pengojë procedurat e DHS-së apo të kryerje krime të tjera.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

43. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarit është proporcional.⁸⁰ ZPS-ja argumenton se ndaj z. Shala janë ngritur katër akuza për krime lufte dhe nëse shpallet fajtor, ai mund të përballet me burgim të gjatë, dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar se rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të

⁷⁵ Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 38; *shih gjithashtu*, Apeli i Paraburgimit të *Thaçit*, para. 64, 67.

⁷⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes të 1 nëntorit 2021, para. 34.

⁷⁷ Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 43; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 39.

⁷⁸ Apeli i Paraburgimit të *Haradinajt*, para. 55; Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 17.

⁷⁹ Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 43; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 39.

⁸⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 2, 7.

Ligjit nuk mund të zvogëlohen me asnjë kusht.⁸¹ Gjithashtu, sipas ZPS-së, hapat e nevojshëm proceduralë që lidhen me fazën paraprake të çështjes gjyqësore vazhdojnë të ecin drejt përfundimit me synimin e kalimit të çështjes për gjykim në të ardhmen e parashikueshme, duke qenë se ZPS-ja i ka nxjerrë të gjitha materialet e kërkuara nga Mbrojtja sipas rregullës 102(3) të Rregullores dhe ka bërë përparim të mëtëjshëm në marrjen e autorizimeve sipas rregullës 107 të Rregullores.⁸²

44. Mbrojtja përgjigjet se paraburgimi i z. Shala është joproportional.⁸³ Mbrojtja argumenton se, duke marrë parasysh paraburgimin e zgjatur para fillimit të gjykimit dhe shkallën e kësaj çështjeje gjyqësore, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të krahasojë kohëzgjatjen e paraburgimit në këtë çështje me çështje të tjera para tribunalëve penalë ndërkombëtarë në kontekst abstrakt.⁸⁴ Mbrojtja parashtron më tej se z. Shala, i cili ka të drejtën të prezumohet i pafajshëm, mbahet në paraburgim për më shumë se 300 ditë, ndërkohë që lirisht mund të supozohet se gjykimi i tij nuk do të fillojë përpara pranverës së këtij viti, sipas parashikimit më të hershëm.⁸⁵ Mbrojtja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të mbajë parasysh se, sa më gjatë z. Shala të qëndrojë në paraburgim, aq më i madh është edhe detyrimi i ZPS-së për të përligjur vazhdimin e paraburgimit të tij.⁸⁶ Për mendimin e Mbrojtjes, kalimi i kohës përbën një ndryshim të rrethanave.⁸⁷ Mbrojtja shton se ZPS-ja pohon pa të drejtë se të gjitha materialet sipas rregullës 102(3) të Rregullores janë nxjerrë.⁸⁸ Sipas Mbrojtjes, kjo periudhë në paraburgim rëndohet edhe më shumë nga masat sanitare në lidhje me pandeminë dhe ndërhyrja e tyre në jetën private dhe familjare të z. Shala, për shkak se familja e tij ka mundur ta vizitojë vetëm pak herë dhe ndërkohë po përballet me vështirësi të mëdha për ta vizituar përsëri, duke qenë se financiarisht

⁸¹ Parashtrimet e ZPS-së , para. 7.

⁸² Parashtrimet e ZPS-së , para. 7.

⁸³ Parashtrimet e Mbrojtjes , para. 7, 22, 25.

⁸⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes , para. 3-4.

⁸⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes , para. 3, 26.

⁸⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes , para. 6.

⁸⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes , para. 19.

⁸⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes , para. 23.

varet prej z. Shala.⁸⁹ Përveç kësaj, Mbrojtja parashtron se z. Shala po përballet me shqetësime dhe ankthe që janë kryesisht pasojë e mundësive mjaft të kufizuara financiare gjatë kohës që ndodhet në paraburgim dhe nuk mund të fitojë jetesën.⁹⁰

45. Në fillim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit në pritje të gjykimit, dhe se sa më gjatë një person mbahet në paraburgim para fillimit të gjykimit, aq më i madh është detyrimi i ZPS-së për të përligjur vazhdimin e paraburgimit.⁹¹ Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është një faktor që duhet marrë parasysh bashkë me shkallën e rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, në mënyrë që pasi të shqyrtohen të gjithë faktorët, të përcaktohet nëse vazhdimi i paraburgimit “pushon së qeni i arsyeshëm” dhe personi duhet të lirohet.⁹² Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se vlerësimi nëse periudha e kaluar në paraburgim para fillimit të gjykimit është e arsyeshme, nuk mund të bëhet në kontekst abstrakt. Arsyeshmëria e vazhdimin të paraburgimit të një të akuzuari duhet të vlerësohet në bazë të fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe në përputhje me veçoritë e saj specifike.⁹³

46. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Shala është mbajtur në paraburgim në Belgjikë që nga 16 marsi 2021 dhe më pas në objektin e paraburgimit të DHS-së, që nga 15 prilli 2021; (ii) ndaj tij janë ngritur katër akuza për krime lufte që pretendohet se kanë ndodhur në Shqipëri gjatë disa javëve; (iii) ai mund të dënohet me burgim të gjatë, nëse shpallet fajtor; (iv) Kushtet e Propozuara, arresti shtëpiak dhe/ose kushtet e tjera shtesë, nuk zvogëlojnë rreziqet e përcaktuara në

⁸⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes , para. 6, 7, 26.

⁹⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes , para. 27.

⁹¹ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73.

⁹² *Po ashtu*, KSC-BC-2020-06, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 69. Një version i redaktuar publik u dorëzua për protokollim të njëjtën ditë, IA002/F00005/RED.

⁹³ *Buzadji v. the Republik of Moldova [GC]*, para. 90.

nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit ; (v) të gjithë hapat e duhur proceduralë që lidhen me fazën paraprake të kësaj çështjeje gjyqësore kanë përfunduar, po përfundojnë ose do të përfundojnë, me synimin e kalimit të çështjes për gjykim në një të ardhme të parashikueshme. Në veçanti, ZPS-ja ka përfunduar nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores dhe vetëm një numër i vogël dokumentesh kanë mbetur për t'u nxjerrë;⁹⁴ është bërë përparim i mëtejshëm në procesin e nxjerrjes së materialeve sipas rregullave 102(3), 103 dhe 107 të Rregullores (konkretisht, ZPS-ja nuk e ka kundërshtuar rëndësinë materiale të dokumenteve të kërkuara nga Mbrojtja sipas rregullës 102(3) të Rregullores,⁹⁵ ka deklaruar se gjatë javëve të ardhshme dhe më së voni deri në konferencën e ardhshme për ecurinë e çështjes, do të shqyrtojë të gjitha materialet e mbetura për të parë nëse përfshijnë prova shfajësuese në pajtim me rregullën 103 të Rregullore,⁹⁶ dhe [REDAKTUAR],⁹⁷ dhe dosja paraprake e ZPS-së bashkë me tabelën sipas rregullës 109(c) të Rregullores do të dorëzohen menjëherë, përkatësisht deri më 28 janar 2022 dhe 11 shkurt 2022;⁹⁸ dhe (vi) afatet përkatëse – disa prej të cilëve janë zgjatur pas paraqitjes së arsyeve bindëse, përfshirë edhe me kërkesë të Mbrojtjes⁹⁹ - janë respektuar ose po respektohen dhe çdo kërkesë tjetër për zgjatjen e afateve do të vlerësohet përkundrejt kritereve ligjore të zbatueshme. Gjithashtu, në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Shala do të rishikohet çdo dy muaj apo kur ka ndryshim të rrethanave.

⁹⁴ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 janar 2022, konfidencial, f. 139-140, f. 142.

⁹⁵ KSC-BC-2020-04, F00127, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Pestë për Ecurinë e Çështjes*, 11 janar 2022, para. 2; Transkripti, 14 janar 2022, konfidencial, f. 144, 145.

⁹⁶ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 janar 2022, konfidencial, f. 150, 158.

⁹⁷ [REDAKTUAR].

⁹⁸ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 23 shtator 2021, publik, f. 92; Transkripti, 14 janar 2022, konfidencial, f. 183.

⁹⁹ *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-04, F00074, *Mbrojtësi i Specializuar, Mocioni i Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Kërkesën e vet sipas Rregullës 102(2) [sic]*, 9 shtator 2021, publik; F00076, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj KSC-BC-2020-04/F00074 dhe Kërkesë Lidhur me Të për Modifikimin e Afateve*, 10 shtator 2021, publike; Transkripti, 23 shtator 2021, publik, f. 92, rreshtat 10-20; F00086, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Kërkesën e vet sipas Rregullës 102(2) [sic]*, 13 tetor 2021, publike.

47. Lidhur me parashtrimin e Mbrojtjes se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të krahasojë kohëzgjatjen e paraburgimit në këtë çështje me atë në çështje të tjera para tribunalëve penalë ndërkombëtarë në kontekst abstrakt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se rishikimi i paraburgimit të z. Shala, si edhe vlerësimi i proporcionalitetit, kryhen ekskluzivisht në bazë të parametrave ligjorë të zbatueshëm në DHS, sikundër përcaktohet më lart.¹⁰⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se rishikimet e mëparshme të paraburgimit të z. Shala nuk janë bërë në bazë të ndonjë krahasimi të tillë abstrakt.¹⁰¹ Gjithashtu, në lidhje me parashtrimin e Mbrojtjes se kalimi i kohës përbën një ndryshim të rrethanave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka vlerësuar si duhet kohën shtesë që z. Shala ka kaluar në paraburgim pas Vendimit të Tretë për Paraburgimin, përfshirë si pasojë edhe detyrimin më të madh të ZPS-së për të përligjur vazhdimin e paraburgimit të z. Shala. Megjithatë, peshuar kundrejt faktorëve të tjerë, në veçanti natyrës së rëndë të akuzave kundër z. Shala, pamundësisë së zvogëlimit të rreziqeve sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit dhe ecurisë së mëtejshme të procedurave, kjo periudhë kohe nuk e bën paraburgimin e z. Shala joproporcional. Për më tepër, në kundërshtim me parashtrimin e Mbrojtjes, fakti që nuk janë nxjerrë të gjitha materialet sipas rregullës 102(3) të Rregullores është gjithashtu i pamjaftueshëm për ta gjykuar paraburgimin e z. Shala si joproporcional, duke qenë se, sikurse është pranuar nga vetë Mbrojtja, është bërë përparim lidhur me nxjerrjen e këtyre materialeve dhe, gjithashtu, [REDAKTUAR].¹⁰²

48. Lidhur me parashtrimet e Mbrojtjes për të drejtën e z. Shala për t'u prezumuar i pafajshëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se paraburgimi i z. Shala është urdhëruar në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren, çka nuk cenon të drejtën e tij për t'u prezumuar i pafajshëm. Gjithashtu, në lidhje me argumentet e Mbrojtjes për të drejtën

¹⁰⁰ *Shih*, para. 18 më lart.

¹⁰¹ *Shih*, për shembull, Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 16.

¹⁰² KSC-BC-2020-04, F00090, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Ndryshimin e Afatit lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3)*, 19 tetor 2021, publik, para. 16, 18(b).

e z. Shala për jetë private dhe familjare, pamundësia e vizitave të rregullta nga familja ka përbërë, sikurse është përcaktuar më parë,¹⁰³ një masë proporcionale dhe të përkohshme, të domosdoshme për shkak të shqetësimeve në lidhje me shëndetin publik, dhe këto kufizime tani janë hequr.¹⁰⁴ Për më tepër, Zyra Administrative e ka informuar rregullisht Mbrojtjen për masat e zbatueshme,¹⁰⁵ që është pranuar edhe nga Mbrojtja.¹⁰⁶ Sidoqoftë, shpeshtësia e vizitave familjare nuk mund t'i atribuohet DHS-së dhe është me rëndësi që z. Shala vazhdon të ketë mundësinë të komunikojë me anëtarët e familjes në mënyra të tjera. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se nuk duhet t'u jepet rëndësi shumë e madhe parashtrimeve lidhur me shqetësimet dhe ankthin e z. Shala si pasojë e mjeteve të kufizuara financiare të tij, dhe se kjo nuk ndikon në vlerësimin e proporcionalitetit, duke pasur parasysh akuzat e rënda kundër z. Shala dhe praninë e mëtejshme të rreziqeve sipas nenit 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit, të përmendura më lart.

49. Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se koha që z. Shala ka kaluar në paraburgim para fillimit të gjykimit nuk është joproporcionale. Gjithashtu, duke pasur parasysh se nuk është arritur marrëveshje lidhur me fillimin e gjykimit,¹⁰⁷ çdo diskutim lidhur me kohëzgjatjen e gjithsejtë të paraburgimit në pritje të gjykimit mbetet i parakohshëm dhe hamendësues.¹⁰⁸

¹⁰³ Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 48; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 45.

¹⁰⁴ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 janar 2022, konfidencial, f. 181.

¹⁰⁵ *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-04, Transkripti, 23 shtator 2021, publik, f. 96-97; Transkripti, 14 janar 2022, konfidencial, f. 181-182.

¹⁰⁶ *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-04, Transkripti, 21 qershor 2021, publik, f. 64.

¹⁰⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 3.

¹⁰⁸ *Shih gjithashtu*, Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 43; Apeli i Paraburgimit të *Thaçit*, para. 51.

V. VENDIM

50. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Shala;
- (b) **URDHËRON** Mbrojtjen që, në rast se dëshiron, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala, jo më vonë se të **mërkurën, 2 mars 2022**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- (c) **URDHËRON** ZPS-në që, në rast se z. Shala vendos të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të paraqesë parashtrimet e veta në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se të **enjtën, 10 mars 2022**, dhe z. Shala që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrimet e tij jo më vonë se të **premtën, 18 mars 2022**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 28 janar 2022

Në Hagë, Holandë.